

Statuti i Shoqatës Humanitare Zhunica

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë emër Shoqata Humanitare Zhunica e themeluar në vitin 2005. Tashmë udhëhiqet si Shoqatë e pavarur, jopartiake dhe joqeveritare e qytetarëve që jetojnë në territorin e Konfederatës Zvicerane dhe jashtë saj e që janë me origjinë nga Zhunica, komuna e Preshevës.

Neni 2

Emri i plot i shoqatës është: **Shoqata Humanitare Zhunica (SH.H.ZH)**

Shoqata Humanitare Zhunica në Zvicër është organizim i krijuar me vetë vullnetin e lirë të bashkatdhetarëve nga Zhunica që jetojnë në Konfederatën Zvicerane dhe jashtë saj. Synon hapjen e nëndegëve tjera nëpër Shtete tjera ku jetojnë bashkatdhetarët tanë nga Zhunica është Shoqatë jo qeveritare dhe jopartiake me karakter social, humanitar dhe kulturor, që mbështetet në parimet Demokratike Kushtetuese, mbi ligjet e Konfederatës Zvicerane dhe Normat Ndërkombëtare të së Drejtës.

Neni 3

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues përbëhet nga të paktën një Anëtar prej secilës Mëhallë dhe zgjedhet nga mbledhja e përgjithshme e Kuvendit (Asamblesë) për një afat prej 2 viteve me të drejtë rizgjedhje. Këshilli Drejtues përbëhet me Delegatët e Mëhallës dhe është vendim marrës me më së paku 2/3 e Antarëve të pranishëm. Delegatët janë të obliguar për pjesmarrje në mbledhjet e organizuara nga Kryesia, (në pamundësi të pjesmarrjes, Delegati obligohet ta dërgojë një Zëvendësues). Këshilli Drejtues do të mblidhet me kërkesë të Kryetarit ose me kërkesë të një anëtari të Këshillit Drejtues. Zgjidhen Anëtarët e Këshillit gjatë një mandati dhe njëkohësisht zgjidhet Kryesia e re (Kryetari, Sekretari dhe Arkatari) me një Mandat 4 Vjeçar me të drejtë rizgjedhjes dhe bëhet emërimi i 2 verifikuesve të Buxhetit. Kryesia e Shoqatës obligohet që për çdo projekt si dhe dërgimimin i mjeteve financiare për në vendlindje apo në raste të veçanta diku tjetër, të mirret me pëlqimin e më së paku 2/3 delegatëve të pranishëm . Kryesia ka të drejtë të marr vendime për ndonjë projekt të vogël si dhe tërheqjen e mjeteve financiare deri në shumën 1000 Fr mbrenda vitit edhe pa thirrjen e mbledhjes së Delegatesve, por njëkohsisht, obligohet që më vonë të i njoftoj Delegatesve për vendimin e marr.

Neni 4

Synimet dhe objektivat e shoqatës

Organizon takime të rregullta me mërgimtarët e fshatit Zhunicë, me synim bashkimin e mërgimtarve, njoftimin e të rinjëve në mes veti, informimin me rrjedhat në vendlindje etj. Shoqata ka për qëllim grumbullimin e mjeteve materiale e financiare për nevoja humanitare. Ndihton me veprimtarinë e vet në shumë fusha ekologjike në fshat: mirëmbajtjen Varrezave, Parkut, Rrugëve, Kanalizimit, gjelbërimin e Fshatit dhe për nevoja urgjente. Shoqata synon zgjerimin e veprimtarisë së vet me manifestime të ndryshme : Kulture, Sportive etj.

Neni 5

Kryesia përbëhet nga

- ✓ Kryetari
- ✓ Sekretari
- ✓ Arkatari dhe
- ✓ Antarët tjerë të kryesisë të cilët janë përfaqësues nga secila Mëhallë.

Neni 6

Kryetari i Shoqatës ka këto kompetenca

1. Drejton veprimtarinë e Këshillit Drejtues, në bazë të ligjit dhe Statusit.
2. Mbikqyr aktivitetet e Shoqatës.
3. Nënshkruan vendimet e Shoqatës si dhe të gjitha Aktet e tjera të miratuara nga Mbledhja e Përgjithshme dhe Këshilli Drejtues në emër të Shoqatës.
4. Përfaqëson Shoqatën në Ceremoni zyrtare.
5. Administron fondet sipas mënyres së caktuar nga Këshilli Drejtues.
6. Kujdeset për interesat e Shoqatës dhe mbron ato në bazë të rregullores së Statusit.

Neni 6

Sekretari Shoqatës ka këto kompetenca

1. Organizon dhe eventualisht edhe moderon mbledhjet.
2. Kryen detyra administrative, si shkrimin dhe dërgimin e procesverbalit.
3. Kontrollon arkivin e Shoqatës në të gjitha format.
4. Propozon pikat ditore për në mbledhje.
5. Kryen punë të tjera të deleguara dhe të besuara nga Kryetari i Shoqatës.

Neni 7

Arkatari i Shoqatës ka këto kompetenca

1. Të mbaj dhe menaxhoj financat e Shoqatës.
2. Për çdo shpenzim dhe të ardhura, duhet me shkrim të informojë Kryesinë.
3. Për çdo shpenzim duhet të mbaj procesverbal të nënshkruar nga Kryetari Shoqatës.

Neni 8

Delegatët e Shoqatës i kan këto kompetenca

1. Kujdesen për mbarvajtjen e Shoqatës.
2. Përfaqsojnë intesetat e Mëhallës përkatëse.
3. Janë përgjegjës për grumbullimin e mjeteve materiale dhe identifikimin e Antarëve të rinjë për Mëhallën që e përfaqsojnë.
4. Bëjnë zgjedhjen e Kryesisë.
5. Komunikojnë drejtpërdrejt me Kryesinë dhe anasjelltas me Antarët e Mëhallës përkatëse.
6. Marrin pjesë në vendim marrje në çdo Projekt.

Neni 9

ANTARSIA

1. Antarë të Shoqatës mund të jenë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë aftësi për të vepruar dhe që pranojnë e respektojnë qëllimin e shoqatës dhe poashtu janë të gatshëm ti promovojnë ato vlera.
2. Antarësimi dhe veprimet humanitare të antarëve të Shoqatës bëhen në bazë të parimeve vullnetare. Për punën që kryejn Antarët ashtu edhe Kryesia e Shoqatës nuk ju parashihet ndonjë lloj kompensimi material, gjithashtu nuk ka të drejtë asnjë Anëtar të kërkojë pagesë, pasi që është Organizatë Humanitare jofitimprurëse.
3. Antarë i Shoqatës konsiderohet çdo person i cili e kryen pagesën obligative të Shoqatës.
4. Shuma e antarësisë është :
 - ✓ 100 Fr. për çdo të punësuar në Zvicërr.
 - ✓ 50 Fr. për çdo Pensionistë në Zvicërr.
 - ✓ 20 Fr. për të Rinjët që janë në Shkollim e sipër në Zvicërr.
 - ✓ 50 -100 Euro për të punsuarit në shtet tjera.
 - ✓ 10 – 20 Euro për të Rinjët që janë në Shkollim e sipër në shtet tjera .

Neni 10

Burimet financiare të Shoqatës

1. Burimet financiare të Shoqatës, burojnë nga Antarësia si dhe nga donacionet e Personave fizik dhe juridik që veprojnë brenda teritorit të Zvicrës dhe jasht saj. Shoqata ka xhiro-llogarinë e vet Bankare, nëpërmjet së cilës kontrollohet dhe realizohet puna e Shoqatës.
2. Për detyrimet, Shoqata përgjigjet për tërë pasurinë e sajë dhe askush nuk mban përgjegjësi personale përveç në raste kur dëmet mund të jenë shkaktuar me paramendim dhe qëllim. Anëtarët të cilët janë larguar nga shoqata në cilëndo formë para se të përfundojë së ekzistuari Shoqata, nuk kanë të drejtë kompenzimi në burimet e Shoqatës.
3. Viti financiar përputhet me përfundimin e vitit më 31 Dhjetor llogaritë vjetore janë plotësuar dhe përmbyllur.